

PËRSE PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DUHET TË JENË PRIORITET PËR VAKSINIMIN NDAJ COVID-19?

Shtetet duhet të marrin vendime për grupet që duhet të kenë përparësi në vaksinat COVID-19, në mënyrë që të shpëtohen sa më shumë jetë të jetë e mundur.

Këto vendime duhet të bazohen në dy kritere:

- Për të mbrojtur grupet dhe individët më të rrezikuar dhe
- Për të ngadalësuar dhe përfundimisht ndaluar përhapjen e sëmundjes

Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë rreth 15% të çdo popullsie. Për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre, ata janë më të rrezikuar nga COVID-19.

Personat me aftësi të kufizuara dhe rrjeti i tyre mbështetës: kujdestarët, asistentët personalë interpretët e gjuhës së shënjtave, njerëzit që punojnë në shërbimet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, duhet të identifikohen si një grup përparësor për vaksinimin për disa arsye:

Disa persona me aftësi të kufizuara...

- Kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme me një ndihmës personal, përkthyes ose persona të tjerë mbështetës - prandaj distancimi fizik nuk është i mundur ose është shumë i kufizuar.
- Janë të detyruar të jetojnë në ambiente të përbashkëta ku mundësitë e infektimit janë shumë të larta (institucione, spitale psikiatrike, kampe refugjatësh)
- Mund të kenë rrethana shëndetësore ekzistuese ose të jenë në moshë të thyer që i vendosin në rrezik më të madh infektimi nga Covid-19
- Mund të kenë rrethana të tjera shëndetësore që kërkojnë më shumë akses në shërbimet shëndetësore dhe për këtë arsye ndodhen në vende publike që krijojnë rrezik infektimi.
- Përballen me diskriminim në aksesin në kujdesin shëndetësor dhe trajtime.
- Nuk marrin këshilla për shëndetin publik në një formë të përshatur.
- Jetojnë në varfëri dhe kjo rrit të gjitha rreziqet që lidhen me shëndetin, përfshirë COVID-19.
- I përkasin grupeve të tjera të marginalizuara dhe kjo rrit diskriminimin dhe rreziqet për t'u infektuar nga COVID-19- për shembull gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, romët me aftësi të kufizuara, refugjatët me aftësi të kufizuara kanë qenë në një rrezik më të lartë të infektimit dhe vdekjes nga COVID-19.

Ky dokument është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.